REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

Nr 6963 prot

Lushnjë ,më 14 / 07 /2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

PËR " PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS , DREJTORIA VENDORE LUSHNJE".

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë!

Pranë Institucionit të Bashkisë Lushnje janë paraqitur 2(dy) kërkesa nga **Z.Eduart Hazis Xhebexhiu** dhe **Kajmak Ismail Hima** (si përfaqësues i Genci Stambolliu me prokurë nr.rep:1047 , nr. kol:608 , datë 03.03.2026 me objekt përfundimin e proçedurës së privatizimit të banesës shtetërore.

Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi , konkretisht:

- Vkm nr.97 , datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave".
- Ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore",
- Ligji nr.9321, datë 25.112004 "Për Privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa , të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore;
- Vkm nr.179, datë 26.02.2020 "Për rregullat , kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i Ligjit nr.7652, datë 23.12.1992", i ndryshuar;

rezulton se aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin të plotë ligjor , përkatësisht:

- Çertifikatën përkatësisht të vitit 1.12.1992;
- Mandat-arkëtimet që vërtetojnë shlyerjen e plotë të vlerës monetare të banesës sipas tarifave të përcaktuara në legjislacionin përkatës;
- Formularin nr.2 , ku pasqyrohen elementët e përllogaritjes së vlerës , kategoria dhe vendodhja e banesës;
- Formularin nr.3 (kontrata tip) me ish -Ndërmarrjen Komunale të Banesave

- Planimetritë dhe planvendosja e objektit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se aplikuesi ka përmbushur detyrimet financiare dhe procedurale për privatizimin e banesës , por mungon formalizimi përfundimtar i kontratës së shitblerjes përpara noterit , çka ka sjellë mosregjistrimin e pronës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në këto kushte , për vijimin dhe përmbylljen e procedurës së privatizimit , kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak për përfundimin e procedurës dhe autorizimin për lidhjen e kontratës , me qëllim regjistrimin përfundimtar të pronës pranë Drejtorisë Vendore të Kadastrës Lushnje.
Sa më sipër , paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak.

Faleminderit për mirëkuptimin !

Konc:M.Rabia

DREJTORI JURIDIK

Bedri Hida

Adresa:Lagjia Adresa:Lagjia "Kongresi" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

Nr 6863/1 Prot.

Lushnjë, më 14/07/2026

PROJEKT - VENDIM

NR. 63 DATË 14/07/2026

PËR "PËRFUNDIMIN E PROÇEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS , DREJTORIA VENDORE LUSHNJË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2026 në mbështetje të: Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM Nr.97, datë 3.2.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe i Ligjit Nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", pika 3 dhe pika 8 e VKM Nr. 179, Datë 26.2.2020 "Për rregullat, kushtet dhe proçedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit Nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për Privatizimin e Banesave Shtetërore", Ligji Nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për Privatizimin e Banesave dhe Objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e Shoqërive dhe të Ndërmarrjeve Shtetërore", i ndryshuar, pika 2, pika 3/3 dhe pika 12 e VKM Nr. 320, datë 06.05.2026, Dekretit të Presidentit nr. 1440 datë 04.04.1996 "Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara", neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, paragrafi II "… regjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykatë apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj…" si edhe neni 193/b të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, **JU**

PROPOZOJMË:

I. Të përfundojnë procedurat e privatizimit të apartamentit dhe të lidhet kontrata e privatizimit para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë ASHK–së,Drejtoria Vendore Lushnje, *sipas dokumentacionit përkatës të privatizimit të ndodhur në dosjet për qytetari*

a)Z.Genci Tili Stambolliu dhe në favorë të bashkëpronarëve sipas dëshmisë së trashëgimisë me Nr.repertori:3770, Nr.koleksioni:1823, datë 15.12.2016 dhe sipas dëshmisë së trashëgimisë me Nr.1767,Nr.Kol 1045, datë 10.04.2026, vendodhja e banesës: fshati "Kolonjë"; Njësia Administrative "Kolonjë"; Bashkia Lushnjë , lloji i pasurisë (apartament), kati III , shkalla I , e përbërë nga 2+ 1 (2 dhoma+ 1 kuzhinë), sipërfaqe totale 84.50m2;

b)Znj.Ruzhdije Osman Xhebexhiu dhe në favorë të (bashkëpronarëve)sipas dëshmisë së trashëgimisë me Nr.repertori:351 , Nr.koleksioni:200, datë 24.04.2026, vendodhja e banesës: *lagjja "Gafurr Muço",Njësia Administrative Nr.4 , Bashkia Lushnjë,*lloji i pasurisë (apartament), kati i V-te , shkalla I , e përbërë nga 2+1 (2 dhoma +1 kuzhinë), sipërfaqe totale 74.00m2 ;

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnjë ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORI JURIDIK
Bedri HIDA

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia Adresa:Lagjia "Kongresi" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com